



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1059, datë 25.11.2009

“Mbi përfundimin e procedimit administrativ për lidhjen e MI midis *interkoneksionit midis Albania Carrier Telecommunications dhe Vodafone Albania* ”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

- | | |
|----------------------|---------|
| 1. Z. Ilir Shehu | Kryetar |
| 2. Z. Afrim Tonuzi | Anëtar |
| 3. Znj. Edlira Kasaj | Anëtar |
| 4. Z. Ilir Zela | Anëtar |
| 5. Z. Jetmir Karini | Anëtar |

dhe sekretare të Këshillit Drejtues Znj. Marsida Dushku, në mbledhjen e datës 25.11.2009, sipas procedurës së përcaktuar në nenin 7 e në vijim të Rregullores së Brendshme, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike dhe Postare në Republikën e Shqipërisë”, me objekt: “Mbi përfundimin e procedimit administrativ për lidhjen e MI midis Albtelecom Sh.a dhe Fjoers Online, US Partners.”

mori në shqyrtim materialet shkresore të përbëra nga:

- Relacioni
- Projekt Vendimi
- Projekt-Urdherat

BAZA LIGJORE:

1. Neni 100 e në vijim i Ligjit Nr.8584 datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” .(**Kodi i Procedurave**)

2. Neni 50 dhe neni 60 të ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr.9918**)
3. Pika 8 e Kreut VI, të rregullores “Për aksesin dhe interkoneksionin” (**Rregullorja**), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 416, datë 7.12.2007 dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;
4. pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (**Rregullorja e Brendëshme**), e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918;

Nga shqyrtimi i materialit të paraqitur, seancës dëgjimore të zhvilluar në datë.11.09.2009, fakteve dhe argumentave të dorëzuar nga palët, si dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar :

V Ë R E H E T se :

Me Vendimin Nr. 946, datë 25.08.2009 Këshilli Drejtues i AKEP ka vendosur fillimin e procedimit administrativ për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së Interkoneksionit midis sipërmarrësve Albania Carrier Telecommunications (ne vijim referuar ACT) dhe Vodafone Albania.

Ne zbatim te vendimit, palet kane depozituar pretendimet e tyre: Vodafone me shkresen Ref.LGD/0310/AC, date 7.09.2009 dhe ACT me shkrese nr.prot.19, date 04.09.2009.

Me palët në procedim ACT dhe Vodafone Albania, u zhvillua një seancë dëgjimore në AKEP në datën 10.09.2009,

Mosmarrëveshja midis palëve konsiston në mos-pranimin nga Vodafone per te lidhur marrveshje interkoneksioni me ACT.

Nga shkresat e depozituara ne AKEP, vihet re se:

Vodafone me shkresen Ref.LGD/0310/AC, date 7.09.2009:

- ACT ka paraqitur kerkese per interkoneksion dhe Vodafone i ka kerkuar plotesimin e dokumntacionit te nevojshme, nder te tjera edhe numeracionin perkates i ACT me qellim kryerjen e testimeve, sipas pocedures standarte per lidhje ml, bazuar ne RIO te Vodafone;
- ACT ka pranuar se nuk ka numracion te alokuar nga AKEP;
- Me shkresen e Vodafone me ref:LGD/0253/AC, date 13.07.2009, drejtuar ACT ne pergjigje te letres se date 15.06.2009 te ACT, Vodafone ka parashtruar se:
 - o ne baze te informacionit te marre nga ACT, konstatohet se ACT nuk ka asnje abonent ne Shqiperi dhe nuk ofron sherbime telefonike ndaj publikut ne Shqiperi, si dhe nuk k ate alokuar asnje lloj nueracioni nga AKEP, apsi nuk ofron sherbime telefoike

per publikun. Pra, ACT nuk mund te perfitoje interkoneksion pasi ACT nuk zoteron rrjet publik te komunikimit.

- o Vodafone ka argumentuar se Interkoneksion ne kuptimin e nenit 3 te ligjit 9918, eshte:

lidhja fizike dhe logjike e rrjeteve publike të komunikimit, të cilat përdoren nga operatorët, në mënyrë që t'i lejojë përdoruesit e një operatori të komunikojnë me përdoruesit e një operatori tjetër. Interkoneksioni është një lloj i veçantë aksesi, që zbatohet ndërmjet operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit.

Bazuar ne sa me siper, duke qene se ACT nuk permbush kete parakusht themelor, Vodafone nuk mund ti pergjigjet kesrkeses se ACT per interkonkesion.

- o Vodafone me pas argumenton se AKEP ne vendimet per RIO, ka paracaktuar qe oferta reference e interkoneksionit nenkupton nderlidhjen e dy rrjeteve te ndryshme te operatoreve te ndryshem qe ofrojne sherbime publike telefonike ne Republiken e Shqiperise.
 - o Prejkt rregullorja per Aksesin dhe Interkoneksionin, i referohet nderlidhjes se dy rrjeteve publike te komunikimit elektronik.
 - o Ne takimin e zhvilluar midis ACT dhe Vodafone me 14.07.2009, Vodafone ka kundërshtuar pretendimin e ACT se pika 2 e nenit 2.2 te projekt Rregullores per Aksesin dhe Interkoneksionin i jep te drejten ACT te kerkoje interkoneksion pavaresisht nese telefonatat jane origjinuar ne Republikën e Shqipërisë ose ne një vend tjetër, pasi perseri kjo e drejte i lind vetem operatoreve te rrjeteve publike te komunikimeve elektronike ne Repbliken e Shqiperise. Pra nje operatori qe zoteron rret publik dhe me ante se cilit ofron sherbime per publikun ne Shqiperi.
 - o Sherbimet nderkombetare jane liberalizuar nga 1.01.2005, dhe Vodafone ka te drejte te rrugeoje trafikun nderkombetar neprmjet carrierave te huaj apo shqiptare qe plotesojne kushtet ne fjale dhe nuk eshte e detyruar ta bleje tranzitimi nderkombetar nga cdo operator.
 - o Vodafone kerkon marrjen e vendimit nga AKEP, per mos njohur te drejten e ACT per te lidhur marrveshje interkoneksioni, per sa kohe qe nuk zoteron rrjet publik te komunikimit ne Republiken e Shqiperise, se bashku me numeracionin qe caktohet per kete arsye.
- Operatori ACT me shkrese nr.prot.19, date 04.09.2009 (nr.prot.3488, date 07.09.2009 -ref AKEP) ka parashtruar si vijon:
- o ACT eshte mbajtes i autorizimit te pergjithshem te konfirmuar nga AKEP Nr:1737/1, date 15.04.2009 dhe ofron sherbime te tranzitimit te thirrjeve kombetare dhe nderkombetare.
 - o Me konfirmimin e niftimit shprehet qarte e drejta e negocimit te aksesit dhe interkoneksionit me operoret e tjere;

- o Kjo e drejte ka gjetur zbatim me operatorët AMC dhe Albtelecom me të cilët janë nënshkruar Mi-te bazuar në RIO-t perkatese;
 - o ACT ka ndjekur të gjitha hapat e kërkuar nga ligji për të ushtruar këtë të drejtë me operatorin me FNT, Vodafone Albania, por nga ky operator nuk është respektuar asnjë aftë që kërkon ligji
 - o Sjellja e Vodafone është tipike e sjelljes së operatorëve me FNT duke demtuar konkurrencën dhe shkelur ligjin dhe demin i shkaktuar nga Vodafone është shumë i madh pasi ekzistojnë prej kohësh kontratat të nënshkruara me operatorët internacionale.
- Në seancën degjimore të zhvilluar me të dy palët në AKEP, datë 10.09.2009, palët përveç qendrimeve të shprehura në pretendimet me shkrim, parashtruan sa vijon:
- o Vodafone mbrojt qendrimin se ACT nuk mund të konsiderohet operator rrjeti publik të komunikimeve përderisa nuk ofron shërbime përdoruesve (fundore apo me shumicë) në Shqipëri dhe nuk ka numeracion të alokuar nga AKEP;
 - o ACT u përgjigj pyetjeve të AKEP për mënyrën e ofrimit të shërbimit të njoftuar, duke sqaruar se ACT kryen tranzitim nëpërmjet një centrali, rrjeti qendror dhe kemi kontrata dhe me të huaj, me të cilët lidhen nëpërmjet internetit. ACT ka një rrjet virtual dhe se operator nuk quhet vetëm ai që ka tela. ACT lidhet me Albtelecom nëpërmjet fibrave optike. ACT deklaroi gjithashtu se një pjesë e rrjetit shtë ndertuar vete dhe një pjesë është marrë me qera.
 - o ACT deklaroi se ka lidhur marrëveshje interkoneksioni me AMC dhe Albtelecom dhe pranoi kërkesën e AKEP për të depozituar nga një kopje të tyre në AKEP.

ATEHERE:

Këshilli Drejtues, në zbatim të nenit 60 Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike” dhe nenit 100 të “Kodit të Procedurave Administrative” më shqyrtim të fakteve dhe dëgjimit të pretendimeve në seancën degjimore konstaton se:

- Përkufizimi i Interkoneksionit (me referencë Ligjin 9918) i dhënë nga Vodafone në pretendimet për procedimin administrativ, me shkresën Ref.LGD/0310/AC, datë 7.09.2009, i cituar më sipër, nuk është i saktë, pasi përkufizimi i plotë i interkoneksionit në nenin 3 të ligjit 9918, është si vijon:

“Interkoneksioni” është lidhja fizike dhe logjike e rrjeteve publike të komunikimit, të cilat përdoren nga një operator apo operatorë të ndryshëm, në mënyrë që t’i lejojë përdoruesit e një operatori të komunikojnë me përdoruesit e të njëjtit operator ose të një operatori tjetër, ose të lejojë aksesin për shërbimet e

ofruara nga një operator tjetër. Interkoneksioni është një lloj i veçantë aksesi, që zbatohet ndërmjet operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit”

- Ligji 9918, i jep te drejta dhe detyrime për interkoneksion operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit, por ligji dhe kuadri rregullator, nuk kanë parashikime që të përcaktojnë se operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit, janë vetëm operatorët që ofrojnë shërbime direkt përdoruesve fundorë dhe/ose detyrimin për të pasur numeracion të alokuar nga AKEP për këto qëllime:

“Rrjet i komunikimeve elektronike” janë sistemet e transmetimit dhe, nëse ekzistojnë, sistemet e komutimit ose rrugëzimit dhe burime të tjera, të cilat lejojnë përcjelljen e sinjaleve nëpërmjet përcjellësve, radios, mjeteve optike ose mjeteve të tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjetet satelitore, rrjetet fikse (me komutim të qarqeve ose me komutim të paketave, përfshirë internetin), rrjetet e lëvizshme tokësore, sistemet e kabllave elektrike në raste kur ato përdoren, për transmetimin e sinjaleve, rrjetet e përdorura për transmetimet radiotelevizive, pavarësisht nga tipi i informacionit të përcjellë.

“Rrjet i komunikimeve publike” është një rrjet i komunikimeve elektronike, që përdoret, tërësisht ose pjesërisht, për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, të disponueshme për publikun”

“Operator i rrjetit të komunikimeve publike” është sipërmarrësi, i cili ka të drejtë të ndërtojë, të posedojë, të japë me qira dhe të shfrytëzojë një rrjet të komunikimeve publike dhe facilitetet shoqëruese, si dhe të ofrojë shërbime të komunikimeve publike.

- Gjithashtu në lidhje me këto çështje sjellim në vëmendje dokumentin e Oftel (sot) OFCOM), rregullatori i komunikimeve elektronike të UK: *Guidelines for the interconnection of public electronic communications networks- A statement issued by the Director General of Telecommunications 23 May 2003*, në të cilin midis të tjerave sqarohet se:

4.7 In practical terms, for there to be an ECN there needs to be elements of physical infrastructure such as a network node. Clearly where a provider is operating two network nodes what connects them will count as a transmission system. Thus the communications provider will be providing an ECN. However it would not be desirable to limit the status of an ECN, and hence the rights and obligations of interconnection, to multiple node networks.

4.8 As there is no obligation for the provider of an ECN to own the elements that constitute its network (as discussed in paragraph 4.2 above), the Director currently considers that a provider with a single network node who is willing to obtain transmission infrastructure that builds towards a ECN will fall within the definition of ECN. For example, where provider A seeks interconnection from provider B, the links between provider A's node and provider B's node will constitute provider A's transmission system. This will be the case irrespective of whether the actual link is self-provided, leased from provider B or from another provider altogether, C.

6.1 Oftel's understanding has been that a publicly available service is one that is available to anyone who is both willing to pay for it and to abide by the applicable terms and conditions. The provider will not have imposed an upper limit on the class of potential customers other than those that arise from technical or capacity constraints. A publicly available service is distinguishable from a bespoke service restricted to a limited group of individual and identifiable customers.

Duke dhene si shembull sherbimet e rrjeteve private apo te brendshme te kompanive, institucioneve apo hoteleve.

- Per sa me siper,
 - o dallimi midis rrjeteve publike te komunikimit dhe rrjeteve jo-publike te komunikimit, qendron ne faktin se rrjetet-publike jane rrjetet private apo te kompanive apo institucioneve te ndryshme.
 - o Interkoneksioni nuk perjashton ofrimin e sherbimeve per perdorues me shumice, apo per perdoruesit fundore te nje rrjeti tjetër.
 - o Rrjet i komunikimeve elektronike perfshin edhe rrjetet (sistemet) qe kane vetem nje nyje rrjeti dhe zoterojne¹ (ndertuar vete apo me marre me qera) sisteme (infrastrukture) transmetimi qe lidh kete nyje nje rrjet tjetër te komunikimeve per qellim interkoneksioni.
- ACT ne njoftimin per ofrimin e sherbimeve dhe rrjeteve, ka njoftuar vetem ofrimin e sherbimit te tranzitimit, pa klikuar ofrimin e rrjeteve publike te komunikimeve elektronike megjithese ne pershkrimin e dhene per aplikim, ka perfshire pershkrim te rrjetit (sistemit) te komunikimeve. Ne kete aplikim, te depozituar ne AKEP me shkrese 1737, date 9.04.2009 (protokolli i AKEP), ACT ka pershkruar se zoteron midis te tjerave 2 pajisje komutuese, dy servera tarifimi, dhe do te realizoje interkoneksionin me kompanite e telekomunikacioneve me fiber optike.
- ACT duhet te beje rregjistrimin ne AKEP si ofrues i rrjeteve publike te komunikimeve elektronike, me qellim qe te jete ne perputhje m kuadrin ligjor dhe rregullator per te pasur te drejten dhe detyrimin per interkoneksion.
- Nga marrveshjet e lidhura me Altelecom dhe AMC, rezulton se:
 - o MI me Altelecom parashikon se ACT angazhohet te ofroje per Altelecom sherbime interkoneksioi te tranzitimit te trafikut ne rastin e kerkeses nga ana e Altelecom, me tarifa qe do te bihen dakort midis paleve Altelecom, ndersa Altelecom ofron te gjitha sherbimet si edhe operatoreve te tjere.
 - o MI me AMC, parashikon se ACT ofron sherbimin e terminimit te trafikut ne rrjetin e tij me tarife 3 lek/minute, nderkohe qe nuk ka abonente fundore apo rrjet lokal dhe numeracion per te terminura thirrje ne rrjetin e vet, ndersa AMC ofron te gjitha sherbimet si edhe operatoreve te tjere.

Per sa me siper, Keshilli Drejtues i AKEP,

V E N D O S I :

1. Të urdhërojë, lidhjen e marrëveshjeve të Interkoneksionit brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi të Urdhërave për sipërmarrësit:
 - Vodafone Albania sh.a dhe Albanian Carrier Telecommunications sh.p.k.

¹ Apo deshirojne te zoteroje apo marrin me qera

2. Marrëveshja e interkoneksionit të lidhet sipas RIO-s se Vodafone Albania sh.a miratuar me VKD Nr. 630 datë 10.02.2009.
3. Urdhëri për lidhjen e Marrëveshjeve të Interkoneksionit të hyjnë në fuqi ditën e njoftimeve të tyre.
4. Palët të depozitojnë pranë AKEP Marrëveshjet e Interkoneksionit të lidhura në vijim të urdhrit të dale në zbatim të këtij vendimi.
5. Sipërmarresi ACT të bëjë saktësimet e duhura tek formulari i njoftimit të Autorizimit të Përgjithshëm.
6. Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

KRYETAR I KËSHILLIT DREJTUES

Ilir SHEHU

Anëtarë të Këshillit Drejtues:

1. **Afrim TONUZI**
2. **Edlira KASAJ**
3. **Ilir ZELA**
4. **Jetmir KARINI**